



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 152/4 Prot

Tiranë, më 10/03/2016

VENDIM

Nr. 05, datë 10/03/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit klinika "ADC-Ana Farm" sh.p.k.,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 29 datë 08/02/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit klinika "ADC-Ana Farm", sh.p.k., me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika "ADC-Ana Farm" sh.p.k. i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Kontrolluesi klinika "ADC-Ana Farm" sh.p.k. ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë. Me fillimin e hetimit administrativ, grupi i kontrollit ka konstatuar se kontrolluesi nuk e kishte realizuar "Njoftimin" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21-22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi është penalizuar më parë për mospërbushje të detyrimit për njoftim, duke qenë në shkelje të neneve 21-22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

“I-Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.”

3. Kontrolluesi ka njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave, menjëherë mbas fillimit të hetimit administrativ.

Kontrolluesi nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për grumbullimin, mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave të subjekteve të të dhënave personale, njoftim i cili është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 16/02/2016, si dhe në zbatim të neneve 87-88 të Ligjit nr. 8485/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, më datë 01/03/2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Si përfundim, konkludoj se shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbën “**kundërvajtje administrative**” dhe sanksionohet me gjobë.

- *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë.*

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, pasi lidhet me detyrimin për Njoftim pranë zyrës së K.D.I.M.D.P.-së në lidhje me përpunimin e të dhënave, sigurinë, konfidencialitetin dhe detyrimet që i dalin kontrolluesit nga zbatueshmëria e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 39/1, në të cilin parashikohet se: “*Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë...etj*”.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të nenit 21 dhe 39/1 shkronja “d” të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit “ADC-Ana Farm” sh.p.k., me gjobë në vlerën **50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalim in e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 10/03/2016

